

**SHOQËRIA TREGTARE  
"SHKOLLA E LARTË JO -PUBLIKE LUARASI" SHPK  
TIRANË/ALBANI**



**VENDIM NR. 02 datë 18. 07. 2005  
I ORTAKUT TË VETËM  
TË SHOQËRISË TREGTARE  
"SHKOLLA E LARTË JO –PUBLIKE LUARASI" SHPK**

Në Tiranë, sot në datën 18, muaji Korrik, viti 2005, u mbledh Ortaku i Vetëm i Shoqërisë Tregtare "SHKOLLA E LARTË JO –PUBLIKE LUARASI" SHPK, në selinë e saj, për shqyrtimin e rendit të ditës:

- Shqyrtimi i Raportit të Ekspertit Kontabël të Autorizuar për Vlerësimin e Rezervave dhe Fitimeve të Pashpërndara për Zmadhimin e Kapitalit Themeltar të Shoqërisë, të datës 18 Korrik 2005 të përgatitur nga z. Berti Sotiraq PASHKO, Ekspert Kontabël i Autorizuar;

Ortaku i Vetëm, z. Aleks LUARASI, pasi u njoh me rendin e ditës;

**VËREN SE**

Shoqëria Tregtare "SHKOLLA E LARTË JO –PUBLIKE LUARASI" SHPK, është regjistruar pranë Zyrës së Regjistrimit Tregtar me Vendimin Nr. 28233 datë 16. 09. 2002 të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë.

Ortak i Vetëm i kësaj shoqërie është z. Aleks LUARASI. Kapitali themeltar i nënshkruar i kësaj shoqërie është 100 (njëqind) kuota (pjesë) kapitali me vlerën e 100 000 (njëqind mijë) Lekë. Ky kapital zotërohet nga Ortaku i Vetëm në këtë mënyrë:

**Z. Aleks LUARASI**, zotëron 100 % të kapitalit themeltar të nënshkruar, e barabartë kjo me 100 kuota me vlerën 100 000 (njëqind mijë) Lekë (1 000 Lekë vlera e secilës kuotë);

Me Vendimin Nr. 01 datë 10. 06. 2005, Ortaku i Vetëm i Shoqërisë ka vendosur:

1. Miratimin e llogarive vjetore të shoqërisë tregtare "SHKOLLA E LARTË JO – PUBLIKE LUARASI" SHPK, për vitin financiar 2004 (1 Janar –31 Dhjetor 2004);
2. Zmadhimin e kapitalit themeltar të nënshkruar të shoqërisë tregtare "SHKOLLA E LARTË JO –PUBLIKE LUARASI" me anë të fitimeve të pashpërndara gjatë vitit financiar 2004 (1 janar –31 Dhjetor 2004);
3. Caktimin e z. Berti Sotiraq PASHKO, Ekspert Kontabël i Autorizuar, me Nr. Liçence 07 datë 10 .02. 2000, për vlerësimin e kapitalit themeltar me rezervat dhe fitimet e pashpërndara të shoqërisë, gjendje të datës 31. 12. 2004;
4. Depozitimin e këtij vendimi pranë Zyrës së Regjistrimit Tregtar të Gjykatës së Shkallës së Parë TIRANË.

**Ky vendim është depozituar pranë Zyrës së Regjistrimit Tregtar me Vendimin Nr. 28233/1 datë 13 Korrik 2005 të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë.**

Në vështrim të rendit të ditës, Ortaku i Vetëm kësaj shoqërie, pasi njihet me Raportin e Ekspertit Kontabël të Autorizuar për Vlerësimin e Rezervave dhe Fitimeve të Pashpërndara për Zmadhimin e Kapitalit Themeltar të Shoqërisë, të datës 18 korrik 2005, i përgatitur nga Eksperti Kontabël i Autorizuar z. Berti Sotiraq PASHKO, vëren se ky raport është i drejtë, në përputhje me ligjet në fuqi dhe për këto arsye duhet miratuar. Ortaku i Vetëm, gjithashtu vëren se z. PASHKO, në detyrën e ngarkuar nga ana e saj, ka punuar me seriozitet, në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe etikën e profesionit, gjë e cila vlen për t'u admiruar.

**SHOQËRIA TREGTARE**  
**"SHKOLLA E LARTË JO -PUBLIKE LUARASI" SHPK**  
**TIRANE/ALBANA**

Ne kete raport eshte shprehur dhe menyra e përcaktimit te numrit të kuotave që do të zotërojë çdo ortak i kesaj shoqërie pas zmadhimit te kapitalit themeltar.

Sipas këtij raporti, zmadhimi i kapitalit themeltar të shoqërisë bëhet nga 100 000 (njëqind mijë) Lekë në 45 020 636 , 03 (dyzet e pesë milionë e njëzet mijë e gjashtëqind e tridhjetë e gjashtë presje zero tre) Lekë, e barabartë kjo me 100 (njëqind) kuota (pjesë) kapitali, secila me vlerë nominale prej 451 206 , 3603 (katërqind e pesëdhjetë e një mijë e dyqind e gjashtë presje tremijë e gjashtëqind e tre) Lekë.

Ky kapital do të zotërohet nga ortaku i vetëm në këtë mënyrë:

- a) **Z. Aleks LUARASI**, do të zotërojë 100 % të kuotave (pjesëve) të kapitalit themeltar në vlerën e 45 020 636 , 03 (dyzet e pesë milionë e njëzet mijë e gjashtëqind e tridhjetë e gjashtë presje zero tre) Lekë, e barabartë kjo me 100 (njëqind) kuota (pjesë) kapitali, secila me vlerë nominale prej 451 206 , 3603 (katërqind e pesëdhjetë e një mijë e dyqind e gjashtë presje tremijë e gjashtëqind e tre) Lekë

Për këto arsye, Ortaku i Vetëm, pas shqyrtimit të rendit të ditës,

**VENDOSI**

1. Miratimin e Raportit të Ekspertit për Vlerësimin e Rezervave dhe Fitimeve të Pashpërndara për Zmadhimin e Kapitalit Themeltar të Shoqërisë të datës 18 Korrik 2005, përgatitur nga z. Berti Sotiraq PASHKO, Ekspert Kontabël i Autorizuar;
2. Zmadhimi i Kapitalit Themeltar të nënshkruar të kësaj shoqërie nga 100 000 (njëqind mijë) Lekë në 45 020 636 , 03 (dyzet e pesë milionë e njëzet mijë e gjashtëqind e tridhjetë e gjashtë presje zero tre) Lekë;
3. Numri i kuotave (pjesëve) të kapitalit, mbetet i pandryshueshëm, dhe vetëm vlera e tyre rritet;
4. Vlera e çdo kuote (pjesë) kapitali, kalon nga 1 000 (një mijë) Lekë në 451 206 , 3603 (katërqind e pesëdhjetë e një mijë e dyqind e gjashtë presje tremijë e gjashtëqind e tre) Lekë;
5. Zotërimi i kapitalit do të jetë në këtë mënyrë:
  - **Z. Aleks LUARASI**, do të zotërojë 100 % të kuotave (pjesëve) të kapitalit themeltar në vlerën e 45 020 636 , 03 (dyzet e pesë milionë e njëzet mijë e gjashtëqind e tridhjetë e gjashtë presje zero tre) Lekë, e barabartë kjo me 100 (njëqind) kuota (pjesë) kapitali, secila me vlerë nominale prej 451 206 , 3603 (katërqind e pesëdhjetë e një mijë e dyqind e gjashtë presje tremijë e gjashtëqind e tre) Lekë
6. Depozitimi i këtij vendimi pranë Zyrës së Regjistrimit Tregtar të Gjykatës së Shkallës së Parë TIRANË

**ORTAKU I VETËM**  
**E SHOQËRISË TREGTARE**  
**"SHKOLLA E LARTË JO -PUBLIKE LUARASI" SHPK**

z. Aleks LUARASI

